



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:028203

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874823

KPPP.nr.536/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Paradiso” SH.P.K., me NUI: 810528903, me seli në Lipjan, rruga “Ibrahim Rugova” p.nr., kundër debitorit “Hotel Palace & Spa Center” SH.P.K., me NUI: 811327635, me seli në Mitrovicë, fshati Shupkovc, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.31/22 të datës 20.01.2022, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Hotel Palace & Spa Center” SH.P.K., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.31/22 të datës 20.01.2022, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, për pjesën sa i përket detyrimit në shumën prej 1,400.00 € (një mijë e katërqind euro).
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “Hotel Palace & Spa Center” SH.P.K., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.31/22 të datës 20.01.2022, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 1,403.83 € (një mijë e katërqind e tre euro e tetëdhjetë e tre cent), së bashku me kumatën ligjore sipas normës vjetore të interesit në lartësi prej 8%.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Paradiso” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “Hotel Palace & Spa Center” SH.P.K., sipas urdhrit përmbartimor P.nr.31/22 të datës 20.01.2022, të Përmbartuesit Flamur S. Bogaj, për

shumën prej 1,400.00 € (një mijë e katërqind euro), për shkak të përmbushjes së kësaj pjese të detyrimit.

- IV. URDHËROHET debitori “Hotel Palace & Spa Center” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 1,403.83 € (një mijë e katërqind e tre euro e tetëdhjetë e tre cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.
- V. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Paradiso” SH.P.K., ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 367/2020 të datës 29.06.2020, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,803.83 € me kamat prej 8% nga dita kur borxhi është bërë i arritshëm e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, ashtu që përmbaruesi borxhin ta inkasoi me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat dhe pastaj në llogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në realizimin e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar ndër të tjerash se faturat të cilat janë bashkangjitur në lëndë nuk i takojnë debitorit, vetëm fatura 367/2020 i takon debitorit, mirëpo për të njëjtën faturë debitori ka bërë pagesë në shumë prej 1,400.00 €, andaj shuma që kërkon kreditori me propozimin për përmbarim nuk është e saktë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta anuloj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi është dokument i besueshëm i plotëson të gjitha kushtet sipas LPP-së. Tutje ka shtuar se në prapësimin e debitorit pohohet se i njëjti e

ka pranuar faturën, por i njëjti e ka kontestuar borxhin mirëpo nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi mbi pagesën të cilën pretendon se e ka bërë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.31/22 i datës 20.01.2022 duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr. 367/2020 të datës 29.06.2020.

Gjykata erdhi në këtë përfundim, pasi që në bazë të provave që gjenden në shkresa të lëndës, përkatësisht në bazë të dëshmisë së pagesës nga NLB Banka nr.77702946504011 të datës 30.06.2020, vërtetohet se debitori ka përmbushur shumën prej 1,400.00 € ndaj kreditorit për Faturën Nr.367/2020.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm - fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.31/22 të datës 20.01.2022 për shumën në vlerë prej 1,403.83 €, për faktin se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po

të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr. 367/2020 të datës 29.06.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbarduesit privat edhe në pjesën lidhur me kumatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kumatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbardimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 1,403.83 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kumatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbardimin në tërësi*

ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t’ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.536/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.